SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

NR	Emertimi	Njesia	Specifikimet teknike
1	Zbardhues 2.5 L likuid xhel higjenizues me ngjyre blu dhe me arome	Cope	Të mos ketë përmbajtje të lendeve të ngurta, me erën karakteristike shpuese në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastike. Ambalazhi të jete I etiketuar. Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika dhe të ketë analizën spektrale në ambalazhim. Të jetë cilësore dhe të ketë fuqi të larta pastruese
2	Acid likuid për higjenizimin e wc 1L ose ekuivalencën e e saj	Cope	Acid përpastrim WC, të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbajë HCL jo më pak se 30%. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng i paster, i bardhë, të ketë aromën e freskisë .Të jetë i tretshëm në ujë.
3	Shtupë mikrofibër (për dysheme, me ngjyra dhe të plota)	Cope	Shtupë për larje dyshemeje, e përbërë nga fibra tekstili të buta që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 350 gr.
4	Shkop për shtupe për larje	Cope	Gjatësia e shkopit të jetë minimumi 130 cm.
5	Detergjent pllakash 1 l	Cope	Solucion aromatic cilësor për larje dyshemeje. Ambalazhimi në shishe plastike 1 litroshe. Gjendja fizike të jetë lëng, me aromë lulesh. Të jetë I tretshëm në ujë.
6	Doreza për duart (masa M , L për pastrim)	Cope	E përshtatshme për pastrimin e tualetit. Të mos demtojë lekurën e duarve nga detergjentet. Të jenë praktike në përdorim, dhe të mos pengojë gjatë pastrimit. Dizajn universal I cili u përshtatet të gjithë duarve. Të jete rezistente ndaj nxehtesise.
7	Detergjent për xhamat 1 liter	Cope	Solucion lares xhamash, me efekt pastrimi të njollave dhe pluhurave në xhama. Ambalazhimi në shishe plastike 1 litroshe

			edhe me koke shisheje me mekanizem sprucimi. Gjendja fizike e lengut te jete leng I plote. Të jetë I tretshëm në ujë.
8	Sapun lëng i madh	LITRA	Solucion larës duarsh lëng, me efekt pastrimi, aromatizimi dhe hidratimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng i plotë.
9	Letër për duart Rulo e madhe (2 fijoshe)	Cope	Letër kuzhine 100 % celuloze e butë. rezistente dhe absorbuese. Peshë e saj te jete jo me pak se 1 kg, e perbere nga leter 2 fijoshe.
10	Peceta pastrimi (pluhurash,mikrofiber)	Cope	E përshtatshme për heqjen e pluhurave nga sipërfaqet. Të bëjë të mundur tharjen e ujit nga sipërfaqet. Të mos lërë viza dhe gërvishtje.
11	Sfungjer enesh(me dy ane te bute dhe te ashper,10 cop per pako)	Pako	Sfungjer për larjen e enëve me dorë, të jetë nga njëra anë I butë dhe në anën tjetër pak me I ashpër.Permasat e sfungjerit te jene minimumi 11 cm x 6 cm.
12	Test enesh 400 gr	Cope	Test ne forme xheli ne ngjyre jeshile, me paketim 400gr.
13	Tel enesh (4 cope per pako)	Pako	Tel enësh inoxi, nje pako te permbaje 4 cope.
14	Qese mbeturinash me ngjyre te zeze, te plota rezistente 100x67 cm	Rulo	1 pako të ketë 10 fije (qese). Mundesojnë grumbullimin e mbeturinave të përmasave të ndryshme. Të jene të forta. Të jene te paketuara ne forme ruloje. Gryka e qeses te jete me lidhëse.
15	Shkop per fshesa plastike	Cope	Shkopa inoksi me gjatesi normale,jo me te shkurter se 130 cm.
16	Fshesa plastike	Cope	Fshese plastike me fije plastike per pastrim ambientesh.
17	Detergjent parketi(me spruco dhe me arome)	Cope	Detergjenti për parket dhe laminat, për pastrimin dhe lustrimin e të gjitha dyshemeve të shtruara me parket druri dhe laminati. Dtergjenti te lere nje barrierë të veçantë mbrojtëse në sipërfaqe që i mbron ato nga njollat, gërvishtjet dhe lagështia pa lënë njolla, duke garantuar një shkëlqim afatgjatë. Paketimi te jete ne shishe plastike 1 litrarshe.
18	Leter higjenike (me 3 flete,8 cop per pako)	Pako	1 pako të përmbajë 8 rulona. Diametri i një rulo të jetë minimum 16 cm. Te jenë të buta dhe cilesore. Të mos mbeten në trup pas përdorimit të tyre.
19	Kove plastike	Cope	Kova pastrimi profesionale e cilësisë së lartë, të thella dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër per transportimin e kovës. Të kenë mekanizëm plastik vetështrydhës për shtupën. Kapaciteti mbajtës i kovës të jetë jo më i vogël se 10 litra.
20	Furça per tualetin	Cope	Materiali përbërës i saj te jete plastik. Te përbëhet nga fije sintetike mjaft të forta të cilat heqin çdo papastërti. Diametri: 41.5 cm Lartësia: 13 cm.
21	Vim	Cope	Paketimi te jete 500 gr. Vimi pluhur te kete fortësinë gërryese të përshtatur për nevojat e pastrimit në kuzhinë dhe banjo.Produkti ka një aromë freskuese limoni që e bën pastrimin më të këndshëm.
22	Sapun Tualeti	Cope	Sapun natyral i ngurtë, ka një aromë të këndshme, me efekt pastrimi, aromatizimi dhe hidratimi.

23	Pluhur lares	Kg	Detergjent me erë të këndshme freski, i përshtatshëm për rroba të bardha dhe me ngjyre, per njolla të vështira, madje edhe ato thellë në pëlhurë, për një pastrim të përsosur.
24	Furca Merimanga	Cope	Fshesë për pastrimin e rrjetave të merimangave. Fshesa është e pajisur me fiye të buta sintetike, të cilat ndihmojnë në pastrimin me lehtësi të cepave të mureve.
25	Shkopinj per furca merimanga	Cope	Shkop prej materiali plastik dhe alumini, me gjatësi të rregullueshme, i cili mund të arrijë deri në 170 cm
26	Lopata plastike per mbledhje mbeturina	Cope	Lopatë dore për mbeturinat, me strukturë prej materiali plastik të qëndrueshëm, në ngjyra të ndryshme. Lopata është e pajisur me një shirit prej gome të butë, për të parandaluar rrëshqitjen dhe për të mundësuar një pastrim më të mirë të pluhurit nga sipërfaqet e sheshta. Përdoret për mbledhjen e mbeturinave gjatë pastrimit dhe ka një dorezë ergonomike që lehtëson mbajtjen gjatë përdorimit
27	Kapsula per lavastovilje	cope	Këto kapsula kanë fuqinë të heqin edhe ushqimin e pjekur. Kjo tabletë është efektive edhe në përdorimin e ujit jo shumë të nxehtë deri në 26°, dhe për rezultatet më të mira te përdoren ne programe auto 50-55° C.
28	Qese mbeturinash me ngjyre te zeze, te plota rezistente 30 litra	pako	1 pako të ketë 15 fiye (qese). Mundesojnë grumbullimin e mbeturinave të përmasave të ndryshme. Të jene të forta. Të jene te paketuara ne forme ruloje. Gryka e qeses te jete me lidhëse.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

NR	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Zbardhues 2.5 L lukuid xhel higjenizues me ngjyre blu dhe me arome	Cope	2300		
2	Acid likuid per higjenizimin e wc 1L ose ekuivalencen e saj	Cope	600		
3	Shtupa mikrofibër (për dysheme, me ngjyra dhe te plota)	Cope	1500		
4	Shkop per shtupe per larje	Cope	1000		
5	Detergjent pllakash 1 l	Cope	500		
6	Doreza për duart (masa M , L per pastrim)	Cope	30		
7	Detergjent per xhamat 1 liter	Cope	120		
8	Sapun lëng i madh	LITRA	200		
9	Letër për duart Rulo e madhe (2 fjijshe)	Cope	100		
10	Peceta pastrimi (pluhurash,mikrofiber)	Cope	50		
11	Sfungjer enesh(me dy ane te bute dhe te ashper,10 cop per pako)	Pako	200		
12	Test enesh 400 gr	Cope	1200		
13	Tel enesh (4 cope per pako)	Pako	300		
14	Qese mbeturinash me ngjyre te zeze, te plota rezistente 100x67 cm	Rulo	100		
15	Shkop per fshesa plastike	Cope	700		
16	Fshesa plastike	Cope	1000		
17	Detergjent parketi(me spruco dhe me arome)	Cope	150		
18	Leter higjenike (me 3 flete,8 cop per pako)	Pako	100		
19	Kove plastike	Cope	1000		
20	Furça per tualetin	Cope	30		
21	Vim	Cope	200		
22	Sapun Tualeti	Cope	1000		
23	Pluhur lares	Kg	1500		
24	Furca Merimanga	Cope	50		
25	Shkopinj per furca merimanga	Cope	50		
26	Lopata plastike per mbledhje mbeturina	Cope	70		

27	Kapsula per lavastovilje	cope	200		
28	Qese mbeturinash me ngjyre te zeze, te plota rezistente 30 litra	pako	60		

Afatet e lëvrim:

Artikulli	Përshkrimi	Njesia	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Zbardhues 2.5 L lukuid xhel higjenizues me ngjyre blu dhe me arome	Cope	2300	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.
2	Acid likuid per higjenizimin e wc 1L ose ekuivalencen e saj	Cope	600	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.
3	Shtupa mikrofibër (për dysHEME, me ngjyra dhe te plota)	Cope	1500	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.
4	Shkop per shtupe per larje	Cope	1000	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.
5	Detergjent pllakash 1 l	Cope	500	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
6	Doreza për duart (masa M , L per pastrim)	Cope	30	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
7	Detergjent per xhamat 1 liter	Cope	120	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
8	Sapun lëng i madh	LITRA	200	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
9	Letër për duart Rulo e madhe (2 fijoshe)	Cope	100	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
10	Peceta pastrimi (pluhurash,mikrofiber)	Cope	50	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
11	Sfungjer enesh(me dy ane te bute dhe te ashper,10 cop per pako)	Pako	200	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
12	Test enesh 400 gr	Cope	1200	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
13	Tel enesh (4 cope per pako)	Pako	300	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
14	Qese mbeturinash me ngjyre te zeze, te plota rezistente 100x67 cm	Rulo	100	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
15	Shkop per fshesa plastike	Cope	700	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
16	Fshesa plastike	Cope	1000	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
17	Detergjent parketi(me spruco dhe me arome)	Cope	150	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
18	Leter higjenike (me 3 flete,8 cop per pako)	Pako	100	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
19	Kove plastike	Cope	1000	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
20	Furça per tualetin	Cope	30	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates
21	Vim	Cope	200	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates

22	Sapun Tualeti	Cope	1000	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimimit te kontrates
23	Pluhur lares	Kg	1500	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimimit te kontrates
24	Furca Merimanga	Cope	50	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimimit te kontrates
25	Shkopinj per furca merimanga	Cope	50	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimimit te kontrates
26	Lopata plastike per mbledhje mbeturina	Cope	70	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimimit te kontrates
27	Kapsula per lavastovilje	cope	200	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimimit te kontrates
28	Qese mbeturinash me ngjyre te zeze, te plota rezistente 30 litra	pako	60	NMIPP	30 dite nga data e nenshkrimimit te kontrates

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formular oferte*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020-2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin

ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2023 sipas afatave të percaktuara në ligjin 9632/2006 ”Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet të bashkëngjiten të gjithë vertetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për këtë periudhë.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalente me të, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë një deklaratë me ane të se ciles deklaron se do të bëjë dorëzimin e mallrave sipas sasise dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin nje deklarate per skadencen e detergjenteve, e cila duhet te jete jo me pak se 1 (nje) vit nga momenti i levrimit te mallit.

Shenim: Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. <p>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet</p>

këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nejjshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

-
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

Shtojca 9:

Formulari i Njoftimit të Skualifikimit¹

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

